



## Udhëzimi 30

Shtator 2016

### Prokurimi publik

# Direktivat e BE-së 2014: Prokurimi i sektorit publik dhe i shërbimeve

#### PËRMBAJTJA

- [Hyrje](#)
- [Arsyet e rishikimit të Direktivave 2004](#)
- [Struktura dhe përmbajtja e Direktivave 2004](#)
- [Dispozitat e detyrueshme dhe jo të detyrueshme në Direktivat 2004](#)
- [Dispozitat jo të detyrueshme të lidhura me shpalljen e kufijve minimal kohor](#)
- [Shkelja e detyrimeve të lidhura me pagimin e taksave apo të detyrimeve të sigurimeve shoqërore](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

## Hyrje

Në fund të marsit 2014, pas negociatave të gjera që zgjatën mbi tre vjet, *Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian (GZBE)*<sup>1</sup> publikoi tri Direktivat e reja të prokurimit.<sup>2</sup> Dy nga Direktivat në lidhje me prokurimin e autoriteteve kontraktore të sektorit publik dhe të subjekteve të shërbimeve zëvendësojnë Direktivat e Prokurimit të BE-së të vitit 2004. Direktiva e tretë krijon një regjim të ri, të rregulluar për dhënien e kontratave të koncesionit. Kopjet e Direktivave të reja mund të shkarkohen duke përdorur linkun e mëposhtëm:

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:L:2014:094:TOC>

Afati i fundit që Shtetet Anëtare të BE-së të transpozonin Direktivat e reja të prokurimit në legjislacionin e tyre kombëtar ishte 18 prill 2016. Ky afat i përgjithshëm ishte shtyrë në disa raste për zbatimin e masave të prokurimit elektronik.

Ky Udhëzim i Prokurimit përcakton ndryshimet e mëdha të përfshira në Direktivat e Sektorit Publik dhe të Shërbimeve 2014. Udhëzimi nuk ka për qëllim të ofrojë një analizë shteruese të të gjitha ndryshimeve. Një Udhëzim i veçantë i Prokurimit (31) fokusohet në Direktivën e Koncesioneve 2014/23/BE.

Për t'iu referuar Direktivave janë përdorur termat e mëposhtëm:

“Direktiva e Sektorit Publik 2014”	2014/24/BE	}	të quajtura së bashku “Direktivat 2014”
“Direktiva e Shërbimeve 2014”	2014/25/BE		
“Direktiva e Sektorit Publik 2004”	2004/18/KE	}	të quajtura së bashku “Direktivat 2004”
“Direktiva e Shërbimeve 2004”	2004/17/KE		

Ndryshimet e përshkruara në këtë Udhëzim janë në të njëjtën renditje siç janë paraqitur në Direktivën e Sektorit Publik 2014. Kur ka qenë e nevojshme, i është bërë referencë edhe dispozitave ekuivalente të Direktivës së Shërbimeve 2014.

## Arsyet e rishikimit të Direktivave 2004

Prokurimi publik është një nga instrumentet e bazuara në treg që do të përdoret për të realizuar strategjinë Evropa 2020<sup>3</sup> për rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse duke synuar:

- Të përmirësojë kushtet e biznesit që ai të krijojë inovacione.
- Të inkurajojë përdorimin më të gjerë të prokurimit të gjelbër.
- Të garantojë përdorimin më efikas të fondeve publike.
- T'i mbajë tregjet e prokurimit të hapura në të gjithë BE-në.

Këto synime pasqyrohen në ndryshimet e përfshira në Direktivat 2014, të cilat fokusohen në sigurimin e transparencës, rritjen e fleksibilitetit, dhe në inkurajimin e përfshirjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në prokurimin publik. Dispozitat shtesë merren në

<sup>1</sup> Publikuar në *GZBE* më 28 mars 2014, Vëllimi 57 L 94.

<sup>2</sup> Direktiva 2014/23/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për dhënien e kontratave të koncesionit, 26 shkurt 2014; Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014; Direktiva 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

<sup>3</sup> Shih Komisionin Evropian (3 mars 2010), "Komunikim nga Komisioni - Evropa 2020 - Një strategji për rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse".

mënyrë specifike me çështjet e gjelbra (mjedisore). Është qartësisht e njohur se prokurimi elektronik është një faktor kyç në rritjen e efikasitetit dhe sigurimin e transparencës, ndërkohë që një theks më i madh është vendosur në zhvillimin e proceseve të prokurimit duke përdorur mjete elektronike.

Direktivat 2014 përfshijnë dhe zgjerojnë gjithashtu edhe parimet e prokurimit të zhvilluara në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED), të cilat nuk ishin të mbuluara në Direktivat e vitit 2004. Shembuj të kësaj janë përfshirja e neneve në lidhje me transaksionet e brendshme<sup>4</sup> dhe ndryshimet e kontratave.<sup>5</sup> Në disa raste, kur një vendim i GJED-së, ka çuar në kundërshtime apo edhe paqartësi, Direktivat 2014 lejojnë fleksibilitet më të madh se sa që lejohet nga GJED-ja. Për shembull, dispozita e re në nenin 68 të Direktivës së Sektorit Publik lejon përdorimin e kriterëve që kanë të bëjnë me personelin, si një kriter për dhënien e kontratave në raste të caktuara. Shih komentin më poshtë për nenin 68.

Direktivat 2014 janë të lidhura më ngushtë me njëra-tjetrën se sa Direktivat 2004. Direktiva e Sektorit Publik 2014 përmban fleksibilitet më të madh.

### Struktura dhe përmbajtja e Direktivave 2014

Direktivat 2014 janë strukturuar të dyja sipas të njëjtit rend:

- Dispozitat hyrëse;
- Tabela e përmbajtjes;
- Titujt që përmbajnë nenet – të ndarë në kapituj, të cilët janë të nënndarë në seksione;
- Anekset.

Dispozitat hyrëse nuk përbëjnë dispozita detyruese të Direktivave. Dispozitat hyrëse japin kontekstin dhe sqarimet për dispozitat operative të cilat janë të përcaktuara tek nenet. Dispozitat hyrëse përbëjnë një burim të dobishëm informacioni që ndihmon në interpretimin e neneve.

Anekset përmbajnë informacion dhe kërkesat e referuara në nenet shtesë dhe plotësuese, të tilla si përmbajtja e njoftimeve të kontratës.

### Dispozitat e detyrueshme dhe jo të detyrueshme në Direktivat 2004

Shumica e neneve janë të detyrueshme, dhe shtetet anëtare janë të detyruara t'i zbatojnë ato.

Disa nene nuk janë të detyrueshme, që do të thotë se shtetet anëtare mund të zgjedhin nëse do t'i zbatojnë ato apo jo. Në këtë analizë të prokurimit, dispozitat e këtyre neneve janë referuar si "dispozita të detyrueshme ose jo të detyrueshme".

<sup>4</sup> Çështjet kryesore kanë qenë C-107/98 Teckal dhe C-480/06 Komisioni kundër Gjermanisë. Shih gjithashtu SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik*, Kapitulli 4.

<sup>5</sup> Çështjet kryesore kanë qenë C-454/06 presstext Nachrichtenagentur. Shih gjithashtu Kapitullin 9 të botimit të SIGMA-s mbi GJED-në (Shënimi fundor nr. 4 më sipër).

## Objekti, përkufizimi dhe parimet e përgjithshme

### Neni 1. Lënda dhe objekti

Neni 1 i Direktivës së Sektorit Publik 2014 përmban dispozita të reja, të cilat nuk ishin të përfshira në Direktivat e vitit 2004, duke shpjeguar konceptin e prokurimit publik. Neni thekson se Direktiva zbatohet për të gjitha blerjet nga autoritetet kontraktore, pavarësisht nëse ato janë apo jo të destinuara për qëllime publike.

Dispozita hyrëse bën të qartë se Direktiva e Sektorit Publik e vitit 2014 nuk i detyron shtetet anëtare që të japin me nënkontratë ose të transferojnë shërbimet që ata dëshirojnë të sigurojnë vetë. Direktiva parashikon rregullat e sjelljes që duhet të ndiqen kur Shtetet Anëtare vendosin të nënkontratojnë ose të transferojnë shërbimet. Neni 1 (4) konfirmon se Shtetet Anëtare kanë lirinë të vendosin se si të organizojnë realizmin e detyrave dhe të shërbimeve publike në interesin e përgjithshëm ekonomik dhe si të organizojnë sistemet e tyre të sigurisë sociale.

#### Shërbimet:

Nenin 1 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme që shpjegojnë konceptin e prokurimit publik.

**Eksplorimi i naftës dhe i gazit nuk rregullohet më:** Veprimtaria e eksplorimit të naftës dhe gazit, e cila rregullohet me Direktivën e Shërbimeve 2004, nuk rregullohet më nga Direktiva e Shërbimeve 2014. Dispozita hyrëse shpjegon se përjashtimi i këtij aktiviteti është zgjidhje e përshtatshme, pasi ky aktivitet është subjekt i presionit të mjaftueshëm konkurrues.

**Neni 4 Subjektet kontraktore dhe përcaktimi i të drejtave të veçanta dhe ekskluzive:** Direktiva e Shërbimeve 2014 zbatohet për "subjektet kontraktore", që mund të jenë (i) autoritetet kontraktore, (ii) ndërmarrjet publike, ose (iii) një njësi ekonomike që merr përsipër aktivitete të caktuara të specifikuara dhe vepron mbi bazën e "të drejtave të veçanta ose ekskluzive". Përkufizimi i "të drejtave të veçanta ose ekskluzive" është ndryshuar dhe sqaruar me qëllim të zgjidhjes së disa paqartësive që ekzistonin në përkufizimin e dhënë në Direktivën e Sektorit publik 2004. Tani është bërë një lidhje e qartë me ndikimin e dhënies së një të drejte të tillë të veçantë apo ekskluzive, e cila "ndikon thelbësisht në aftësinë e subjekteve të tjera për të kryer një aktivitet të tillë".

### Neni 10. Përjashtimet

Direktiva e Sektorit Publik 2014 përfshin një numër përjashtimesh të reja specifike për kontratat e shërbimeve. Kategoritë e reja të kontratave të përjashtuara janë si më poshtë:<sup>6</sup>

- Shërbimet juridike, duke përfshirë forma dhe këshilla të caktuara të përfaqësimit ligjor, certifikimin e dokumenteve dhe shërbimeve të vërtetimit të ofruara nga noterët, shërbimet e administruesve të besuar dhe të kujdestarisë dhe shërbimeve ligjore që lidhen me ushtrimin e autoritetit zyrtar.
- Kreditë - referenca ndaj shërbimeve financiare që ishte dhënë në Direktivën e Sektorit Publik të vitit 2004 është ndryshuar dhe ndarë në Direktivën e Sektorit Publik 2014 për t'iu referuar veçmas shërbimeve financiare dhe kredive.
- Shërbimet e mbrojtjes civile, sigurisë civile dhe të mbrojtjes nga rreziku ofrohen nga organizatat ose shoqatat jofitimprurëse dhe jo nga shërbimet e transportit të pacientit.
- Shërbimet e transportit publik të pasagjerëve me tren apo metro – prokurimi dhe sigurimi i këtyre shërbimeve rregullohet me një regjim të veçantë të BE-së<sup>7</sup>.

<sup>6</sup> Për detaje të plota të këtyre kontratave të përjashtuara shih nenin 10.

- Shërbimet e fushatave politike të mbuluara nga kodet e specifikuar të fjalorit të përbashkët të prokurimit (FPP).

Në nenin 14 përcaktohet përjashtimi për kërkimin dhe zhvillimin për lloje të specifikuar kontratash.

#### Shërbimet:

Neni 21 i Direktivës së Shërbimeve 2014 parashikon të njëjtat përjashtime të reja që mbulojnë shërbimet ligjore, kreditë dhe shërbimet e mbrojtjes civile, sigurisë civile dhe të mbrojtjes nga rreziku si dhe shërbimet e transportit publik të pasagjerëve me hekurudhë apo metro. Megjithatë, Neni 21 nuk përfshin asnjë referencë për shërbimet e fushatave politike. Në nenin 32 përcaktohet përjashtimi i kërkimit dhe zhvillimit për lloje të specifikuar kontratash.

### Neni 12. Kontratat publike ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik

Neni 12 kodifikon dhe sqaron jurisprudencën e GJED-së për prokurimet "e brendshme". Ai përcakton rrethanat në të cilat dhënia e kontratës do të konsiderohet si ekuivalente me një organizim të "brendshëm" dhe kështu që përjashtohet nga zbatimi i Direktivës së Sektorit Publik 2014. Dy llojet e situatës janë të mbuluara nga neni 12:

- Kontratat e dhëna nga autoritetet kontraktore për subjekte të ndara juridike që ata zotërojnë: kjo situatë është e mbuluar nga pikat (2) dhe (3) të nenit 12, të cilat kodifikojnë dhe sqarojnë rastet që dalin nga aktgjykimi "*Teckal*".<sup>8</sup>
- Marrëveshjet ndërmjet autoriteteve kontraktore: pika (4) e nenit 12 mbulon këtë situatë duke bërë kodifikimin dhe zgjerimin e rasteve që dalin nga aktgjykimi "*Hamburg*".<sup>9</sup>

Ky nen është mjaft kompleks. Në çdo rast, në mënyrë që të klasifikohen në objektin e nenit 12, organizimet duhet të plotësojnë disa kushte të detajuara.

#### Shërbimet:

Neni 28 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme. Neni 28 zbatohet vetëm për subjektet kontraktore që klasifikohen në përkufizimin e autoriteteve kontraktore.

Përveç neneve 29 dhe 30 të Direktivës së Shërbimeve 2014, dispozitat e nenit 28 kanë të bëjnë edhe me dhënien e kontratave filialeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta. Nenet 29 dhe 30 zbatohen për të gjitha subjektet kontraktore, dhe Direktiva e Shërbimeve 2004 përmbante dispozita shumë të ngjashme.

### Neni 22. Komunikimi

Një theks i madh në Direktivën e Sektorit Publik 2014 është vendosur tek komunikimi me anë të përdorimit të mjeteve elektronike. Supozimi fillestar është që i gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit të kryhet duke përdorur mjete elektronike. Afatet minimale kohore në procesin e tenderit llogariten, në përgjithësi, bazuar mbi supozimin se përdoren mjetet elektronike.

Neni 22 parashikon se mjetet dhe pajisjet që përdoren për komunikim elektronik, duhet të jenë jodiskriminuese, duhet të jenë përgjithësisht të disponueshme dhe ndërvepruese me

<sup>7</sup> Rregullorja (KE) Nr. 1370/2007.

<sup>8</sup> C-107/98 Teckal. Shih gjithashtu SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik*, Kapitulli 4.

<sup>9</sup> C-480/06 Komisioni kundër Gjermanisë. Shih gjithashtu SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik*, Kapitulli 4.

teknologjinë që është në përdorim të përgjithshëm. Në rast se autoritetet kontraktore kërkojnë përdorimin e mjeteve që nuk janë përgjithësisht të disponueshme, atëherë ata duhet të ofrojnë mjete të përshtatshme alternative për akses.

Në raste të caktuara kur komunikimi elektronik nuk është i detyrueshëm në procesin e dorëzimit, atëherë mund të përdoren shërbime postare ose mjetet e tjera joelektronike. Këto raste kanë të bëjnë, për shembull, me situatat ku natyra e specializuar e prokurimit nënkupton se mjetet e prokurimit, pajisjet apo formatet e dosjeve që do të përdoren, nuk janë përgjithësisht të disponueshme apo nuk mbështeten, apo kur kërkohen pajisje shumë të specializuara zyre. Dispozitat e tjera rregullojnë trajtimin e informacioneve të ndjeshme tregtare.

Autoritetet kontraktore të garantojnë se shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit, integriteti i të dhënave dhe konfidencialiteti i ofertave dhe i kërkesave për pjesëmarrje mbrohen në të gjithë komunikimin. Aneksi IV përcakton kërkesat minimale në lidhje me mjetet dhe pajisjet që përdoren për marrjen elektronike të ofertave. Këto kërkesa kryesisht kanë të bëjnë me çështjet e transparencës dhe të integritetit të të dhënave.

**Dispozitat jo të detyrueshme:** Shtetet Anëtare kanë opsionin që të parashikojnë pranimin e nënshkrimeve elektronike. Neni 22 (6) (c) përmban dispozita të detajuara në lidhje me përdorimin e nënshkrimeve elektronike.

#### Shërbimet:

Neni 40 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

## Rregullat për kontratat publike

### Neni 26. Zgjedhja e procedurave

Direktiva e Sektorit Publik 2014 ka pesë procedura konkurruese dhe një procedurë jo-konkurruese. Pesë Procedurat konkurruese janë:

- Procedura e hapur;
- Procedura e kufizuar;
- Procedura konkurruese me negociim;
- Dialogu konkurrues;
- Partneriteti i inovacionit.

Procedura konkurruese me negociim është ndryshuar ndjeshëm. Procedura e partneritetit të inovacionit është e re.

Procedura jokonkurruese është procedura me negociim pa shpallje paraprake.

Shih më poshtë për komente të mëtejshme mbi këto procedura.

**Zgjedhja e procedurës së hapur ose të kufizuar:** Procedurat e hapura dhe të kufizuara janë ende procedurat themelore që mund të përdoren lirshëm nga autoritetet kontraktore pa ndonjë kërkesë për të plotësuar kushtet.

**Kushtet për përdorimin e procedurës konkurruese kur lejohen negociatat:** Sipas direktivave të vitit 2004, kushtet që autoritetet kontraktore duhet të plotësonin në mënyrë që të përdornin procedurën me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ose procedurën e dialogut konkurrues ishin të ndryshme.

Sipas Direktivave 2014, kushtet janë të njëjta për procedurën konkurruese me negociim dhe procedurën e dialogut konkurrues. Këto kushte janë ndryshuar dhe janë shtuar kushte të reja. Kushtet zbatohen për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.

Kushtet janë më të lehta për t'u plotësuar krahasuar me kushtet që parashikoheshin në Direktivat 2004. Recitali 42 shpjegon se autoritetet kontraktore duhet të kenë fleksibilitet më

të madh për të zgjedhur një procedurë prokurimi që parashikon negocime dhe se ky fleksibilitet ka të ngjarë që të rrisë tregtinë ndërkufitare.

Në mënyrë të përmbledhur, kushtet për përdorimin e procedurës konkurruese me negocim janë si më poshtë:

- Nevojat e autoritetit kontraktor nuk mund të arrihen pa përshtatjen e zgjidhjeve të gatshme të disponueshme.
- Punët, furnizimet apo shërbimet përfshijnë projektim apo zgjidhje inovative.
- Kontrata nuk mund të jepet pa negociata paraprake për shkak të rrethanave të veçanta që lidhen me natyrën, kompleksitetin apo strukturën ligjore dhe financiare të saj, ose për shkak të rreziqeve që i bashkëngjiten zbatimit të saj.
- Specifikimet teknike nuk mund të përcaktohen me saktësi të mjaftueshme duke i referuar standardeve të përcaktuara ose specifikimeve teknike.
- Vetëm ofertat e parregullta ose të papranueshme dorëzohen në një procedurë të hapur ose të kufizuar.

#### **Shërbimet:**

Direktiva e Shërbimeve 2014 gjithashtu parashikon pesë procedura konkurruese. Procedurat janë të njëjta si ato të listuara në Direktivën e Sektorit Publik 2014 me përjashtim të regjimit të tretë, i cili në Direktivën e Shërbimeve 2014 quhet ende si "procedura me negocim me ftesë paraprake për konkurrim", si në Direktivën e Shërbimeve 2004. Mënyrat në të cilat mund të përdoren disa nga procedurat, janë më fleksibël se sa sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014.

Neni 44. Subjektet kontraktore janë të lira të përdorin ose procedurën e hapur, ose procedurën e kufizuar apo me negocim me ftesë paraprake për konkurrim. Këto opsione ishin të njëjta edhe sipas Direktivës së Shërbimeve 2004.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që subjektet kontraktore të kenë lirinë e duhur për të përdorur procedurat e dialogut konkurrues apo të partneritetit të inovacionit. Nuk zbatohet asnjë kusht për përdorimin e këtyre procedurave konkurruese kur lejohet negocimi.

Prandaj, subjektet kontraktore kanë lirinë e duhur për të zgjedhur një nga pesë procedurat. Procedura e partneritetit të inovacionit mund të përdoret vetëm kur duhet të prokurohen produktet, shërbimet apo punët e reja.

#### **Nenet 27-31. Organizimi i procedurave konkurruese**

Direktiva e Sektorit Publik 2014 përdor një qasje pak të ndryshme krahasuar me Direktivën e Sektorit Publik të vitit 2004, kur përcakton dispozitat që rregullojnë zhvillimin e procedurave konkurruese. Në Direktivën e Sektorit Publik 2014, neni në lidhje me një procedurë të veçantë përfshin referencën ndaj kufijve minimalë kohorë ligjorë për atë procedurë. Kjo dispozitë do të thotë se kërkesat për një procedurë të caktuar janë më të lehta për t'u ndjekur se sa ato të Direktivës së Sektorit Publik 2004, ku dispozitat për afatet kohore të procedurave të ndryshme kombinoreshin në të njëjtat nene.

#### **Shërbimet:**

E njëjta qasje është përdorur në nenet 45-49 të Direktivës së Shërbimeve 2014.


#### **Neni 27. Procedura e hapur**

Ndryshimi kryesor në lidhje me zhvillimin e procedurës së hapur është futja e një afati minimal më të shkurtër kohorë ligjor për pranimin e ofertave, i cili tani është 35 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës në zyrën e GZBE-së. Kufiri minimal kohor mund të reduktohet në 30

ditë, kur ofertat mund të dorëzohen në mënyrë elektronike. Sipas Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004, afati kohor minimal ishte 52 ditë.

Kur autoritetet kontraktore publikojnë Njoftimin Paraprak të Informacionit (NPI), afati kohor minimal mund të shkurtohet në 15 ditë, por vetëm në qoftë se të gjitha informacionet e kërkuara ka qenë të përcaktuara në NPI dhe në qoftë se NPI-ja është dërguar për botim në mes të 35 ditëve dhe 12 muajve para dërgimit të Njoftimit të Kontratës. Kufiri minimal kohor sipas Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004 në raste të tilla ishte 22 ditë.

Diagrama 1. Procedura e hapur me publikimin e Njoftimit Paraprak të Informacionit (NPI), i cili përmban të gjithë informacionin e nevojshëm.



Urgjenca: në rast urgjence, periudha 35-ditore për pranimin e ofertave mund të reduktohet në jo më pak se 15 ditë nga data e dërgimit të Njoftimit të Kontratës.

#### Shërbimet:

Neni 45 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përfshin dispozita të ngjashme duke parashikuar reduktimin e afatit minimal kohor për pranimin e ofertave deri 35 ditë. Kufiri minimal kohor mund të reduktohet më tej në 15 ditë, nëse përdoret njoftimi tregues periodik. Shih komentin më poshtë për njoftimin tregues periodik.

Afati kohor mund të shkurtohet në 15 ditë vetëm nëse i gjithë informacioni i kërkuar është përcaktuar në njoftimin tregues periodik dhe në qoftë se ky njoftim tregues është dërguar për botim në mes të 35 ditëve dhe 12 muajve përpara dërgimit të Njoftimit të Kontratës.

Zbatohen të njëjtat dispozita që lidhen me urgjencën sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014.

**Koment:** Njoftimi tregues periodik është përfshirë në Direktivën e Shërbimeve 2004 si një alternativë dhe një formë më fleksibël e shpalljes sesa Njoftimi i Kontratës. Sipas Direktivës së Shërbimeve 2004, subjektet kontraktore lejohen të publikojnë njoftime për tregues periodikë paraprakë në GZBE në fillim të vitit buxhetor. Njoftimi tregues periodik mund të mbulojë të gjithë prokurimin e planifikuar nga subjekti kontraktor për vitin e ardhshëm buxhetor. Njoftimi tregues periodik ishte e vetmja shpallje që kërkohej të bëhej në GZBE. Asnjë shpallje apo njoftim i mëtejshëm (thirrje për konkurrim) nuk kërkohet për prokurimin e mbuluar nga njoftimi tregues periodik. Përdorimi i njoftimit tregues periodik mbetet nën Direktivën e Shërbimeve 2014.

Direktiva e Sektorit Publik e vitit 2014 është ndryshuar për të përfshirë një dispozitë të ngjashme, jo të detyrueshme që lejon përdorimin e një Njoftimi Paraprak të Informacionit se një thirrje për konkurrim në lidhje me prokurimet për një periudhë deri në 12 muaj. Kjo



dispozitë jo e detyrueshme është e disponueshme vetëm për lloje të veçanta të autoritetit kontraktor. Shih komentin më poshtë për " Njoftimin Paraprak të Informacionit (NPI) si thirrje për konkurrim" sipas nenit 48.


### Neni 28. Procedura e kufizuar

Ndryshimi kryesor në kryerjen e procedurës së kufizuar është futja e afateve më të shkurtra kohore minimale ligjore.

**Procedura e kufizuar pa Njoftimin Paraprak të Informacionit:** Kufiri minimal kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, si dhe sigurimin nga ana e ofertuesve të informacionit të fazës së përzgjedhjes tani është 30 ditë nga data e dërgimit të Njoftimit të Kontratës në zyrën e GZBE-së.


Kufiri minimal kohor për pranimin e ofertave tani është 30 ditë nga data e dërgimit të ftesës për ofertë. Kufiri minimal kohor mund të reduktohet në 25 ditë kur ofertat mund të dorëzohen në mënyrë elektronike. Sipas Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004, afati kohor minimal për marrjen e ofertave ishte 40 ditë.

Diagrama 2. Procedura e kufizuar, pa Njoftim Paraprak të Informacionit



**Procedura e kufizuar me publikimin e Njoftimit Paraprak të Informacionit:** Kur autoritetet kontraktore publikojnë një Njoftim Paraprak të Informacionit standard, afati kohor minimal për marrjen e ofertave mund të shkurtohet në 10 ditë në qoftë se i gjithë informacioni i kërkuar është përcaktuar në Njoftimin Paraprak të Informacionit dhe në qoftë se Njoftimi Paraprak i Informacionit është dërguar për botim në mes të 35 ditëve dhe 12 muajve përpara dërgimit të Njoftimit të Kontratës.

**Diagrama 3. Procedura e kufizuar me publikimin e Njoftimit Paraprak të Informacionit me të gjithë informacionin e kërkuar**



### Dispozitat jo të detyrueshme të lidhura me shpalljen e kufijve minimal kohor

Shtetet Anëtare mund të miratojnë dy dispozita të detyrueshme në lidhje me thirrjet për konkurrencë dhe afatet minimale kohore.

- **Njoftimi Paraprak i Informacionit si thirrje për konkurrim:** Për informacion mbi këtë dispozitë, shih komentin për Nenin 48 më poshtë.
- **Marrëveshja për afatet më të shkurtra kohore për pranimin e ofertave në procedurën e kufizuar [Neni 28 (4)] dhe në procedurën konkurruese me negociim [Neni 29 (1)]:** Autoritetet nën-qendrore kontraktore mund të caktojnë afatin kohor për pranimin e ofertave me mirëkuptim reciprok me të gjithë kandidatët e përzgjedhur. Në mungesë të një marrëveshjeje, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 10 ditë. Autoritetet nën-qendrore janë autoritete që nuk janë organe kontraktore të qeverisë qendrore të renditura në Aneksin 1. Shih komentin më poshtë për organet e qeverisjes qendrore.

**Koment: Autoritetet e qeverisë qendrore** të renditura në Aneksin 1 janë autoritetet kontraktore që mbulojnë nga Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë për Prokurimin Publik (GPA). Disa nga dispozitat jo të detyrueshme në Direktivën e Sektorit Publik 2014 nuk zbatohen për organet e qeverisjes qendrore, pasi këto dispozita nuk janë në përputhje me kërkesat e GPA-së. Dallimi në mes të autoriteteve kontraktore që janë subjekt i GPA-së dhe i atyre që nuk janë subjekt i saj pasqyrohet edhe në kufijtë monetarë për kontratat e shërbimit dhe furnizimit. Për kontratat e shërbimit dhe të furnizimit që jepen nga organet e qeverisjes qendrore zbatohet një kufi më i ulët financiar se sa për kontratat që jepen nga autoritetet e tjera kontraktore që nuk janë subjekt i GPA-së.

### Shërbimet:

Afatet kohore sipas procedurës së kufizuar: Sipas Direktivës së Shërbimeve 2004, subjektet kontraktore ishin në gjendje të binin dakord me operatorët ekonomikë për afatit kohor për kërkesat për pjesëmarrje që i nënshtroheshin një rregulli të përgjithshëm dhe afateve kohore minimale. Ata ishin gjithashtu në gjendje të binin dakord për kufij më të shkurtër kohorë për pranimin e ofertave. Neni 46 i Direktivës së Shërbimeve 2014 e ruan këtë qasje me kufijtë minimal më të shkurtër kohorë si më poshtë:

- Kërkesat për pjesëmarrje: në përgjithësi 30 ditë, por jo më pak se 15 ditë;
- Pranimi i ofertave: me marrëveshje të përbashkët ose, në mungesë të një marrëveshjeje, 10 ditë.

Dispozita jo e detyrueshme që aplikohet për autoritetet nën-qendrore në Direktivën Sektorit Publik 2014 nuk është përfshirë në Direktivën e Shërbimeve 2014.

### Neni 29. Procedura konkurruese me negociim

"Procedura me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" në Neni 30 të Direktivës së Sektorit Publik 2004 është zëvendësuar në Direktivën Sektorit Publik 2014 me "procedurën konkurruese me negociim". Ashtu si procedura që zëvendëson, procedura konkurruese me negociim është një procedurë me dy faza që fillon me një ftesë për konkurrim. Megjithatë, procedura konkurruese me negociim është e rregulluar në mënyrë më të rreptë. Për shembull, dispozitat specifike kanë të bëjnë me sa më poshtë vijon:

- Afati kohor minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje: 30 ditë;
- Afati kohor minimal për marrjen e ofertave fillestare: 30 ditë ose 25 ditë, kur ofertat mund të dorëzohen në mënyrë elektronike;
- Procedurat urgjente;
- **Dispozitat jo të detyrueshme** mbi përdorimin e NPI-së si ftesë për konkurrim dhe për marrëveshjen e afateve kohore për kthimin e ofertave;
- Përmbajtja e dokumenteve të prokurimit, duke përfshirë detyrimin për të përcaktuar kërkesat minimale që duhet të përmbushen nga të gjithë ofertat dhe mënyrën e paraqitjes së këtij informacioni;
- Negociatat lejohen për të përmirësuar ofertat fillestare dhe të mëvonshme duke iu nënshtuar kushtit që kërkesat minimale nuk mund të negociohen dhe duke iu nënshtuar kushtit për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë ofertuesve;
- Dispozitat e transparencës për informimin e ofertuesit mbi çdo ndryshim të specifikimeve teknike ose dokumenteve të tjera të prokurimit;
- Zhvillimi i procesit në faza të njëpasnjëshme dhe mundësia e zvogëlimit të numrit të ofertave gjatë procesit duke aplikuar kriteret e publikuara të dhënies së kontratës;
- Nuk lejohen negociatat pas pranimin të ofertave përfundimtare;
- Mundësia e dhënies së kontratës pa negociim kur një dhënie e tillë është treguar në thirrjen për konkurrim.

#### **Shërbimet:**

Neni 47 i Direktivës së Shërbimet 2014 përcakton rregullat që zbatohen për "procedurat me negociim me thirrje paraprake për konkurrim". Rregullat janë më fleksibël se sa ato të parashikuara në Direktivën e Sektorit Publik 2014, siç ishte rasti edhe me Direktivat 2004.

Afatet minimale kohore sipas Direktivës së Shërbimeve 2014 janë më të shkurtra se ato në bazë të Direktivës së Shërbimeve 2004. Afati kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje në përgjithësi është 30 ditë, por, në asnjë rast, jo më pak se 15 ditë. Afati kohor për pranimin e ofertave mund të vendoset me marrëveshje të ndërsjellë; në mungesë të një marrëveshjeje, afati kohor është 10 ditë. Negocimi pas marrjes së ofertave përfundimtare nuk është i ndaluar.

#### **Neni 30. Dialogu konkurrues**

Dispozitat që kanë të bëjnë me zhvillimin e dialogut konkurrues janë ndryshuar, në veçanti në lidhje me sa më poshtë vijon: (i) shkalla në të cilën lejohet që të sqarohet oferta përfundimtare; dhe (ii) natyra e negociatave që lejohet të zhvillohen me ofertuesin e identifikuar si ofertuesi që ka dorëzuar ofertën më të mirë.

Ofertat përfundimtare të paraqitura pas mbylljes së dialogut mund të "sqarohen, të specifikohen ose të optimizohen me kërkesë të autoritetit kontraktor". Ky formulim duket se lejon ndryshime më të mëdha se sa ndodhte në bazë të Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004, e cila lejonte që ofertat të "sqaroheshin, të specifikoheshin ose të perfeksionoheshin".

Negociatat e "pas tenderit" lejohen të zhvillohen në mënyrë specifike me ofertuesin e identifikuar si ofertuesi që ka dorëzuar ofertën më të mirë. Këto negociata "mund të kryhen për të konfirmuar angazhimin financiar ose kushtet e tjera të përfshira në ofertë duke finalizuar kushtet e kontratës". Negociatat pas tenderit nuk duhet të modifikojnë materialisht aspektet thelbësore të ofertës dhe nuk duhet të rrezikojnë të shtrembërojnë konkurrencën apo të shkaktojnë diskriminim.

#### **Shërbimet:**

Neni 48 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme, por me kufij minimal më të shkurtër kohor.

#### **Neni 31. Partneriteti i inovacionit**

Partneriteti i inovacionit është një koncept i ri dhe një procedurë e re. Partneritetet e inovacionit kanë për qëllim të jenë partneritete afatgjata që lejojnë si zhvillimin ashtu dhe blerjen e mëvonshme të produkteve, shërbimeve ose punëve të reja dhe inovative. Partneriteti i inovacionit kombinon në një proces (i) caktimin e një ose më shumë partnerëve të inovacionit; (ii) punë paralele të zhvillimi inovativ, ku ka më shumë se një partner inovacioni; (iii) reduktimi i numrit të partnerëve gjatë procesit ku ka më shumë se një partner që në fillim; dhe (iv) opsioni për një autoritet kontraktor për blerjen e furnizimeve, shërbimeve ose punëve të zhvilluara si rezultat i partneritetit inovacionit. "Inovacioni" është përcaktuar në mënyrë jo shteruese në Direktivën Sektorit Publik 2014.

Partneriteti i inovacionit duhet të shpallet në *GZBE* me anë të Njoftimit të Kontratës. Për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është caktuar kufiri minimal kohor ligjor prej 30 ditësh. Autoriteti kontraktor që prokuron një partneritet inovacioni ka një numër opsionesh të ndryshme për drejtimin e procesit të prokurimit dhe strukturimin e organizimeve të vazhdueshme të partneritetit të inovacionit. Këto opsione janë të përcaktuara në Neni 31.

#### **Shërbimet:**

Neni 49 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme, por me një afat më të shkurtër minimal prej 15 ditësh.

### Neni 32. Përdorimi i procedurës me negociim pa shpallje paraprake

Arsyet që justifikojnë përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës kanë ndryshuar. Tabela e mëposhtme krahason arsyet e Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004 me ato të Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2014.

*Shërbimet: Tabela përfshin gjithashtu edhe referenca të dispozitave përkatëse të Direktivave të Shërbimeve 2004 dhe 2014.*

Arsyet e përdorimit të procedurës me negociim pa shpallje paraprake	
Direktiva e Sektorit Publik 2004 Neni 31 <i>Neni 40 i Direktivës së Shërbimeve 2004</i>	Direktiva e Sektorit Publik 2014 Neni 32 <i>Ku janë shënuar ndryshimet kyçe Neni 50 i Direktivës së Shërbimeve 2014</i>
<p><b>N. 31(1)(a) asnjë ofertë ose asnjë ofertues i përshtatshëm ose zbatim jo i përshtatshëm</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontratat e punëve, furnizimeve dhe shërbimeve</li> <li>Procedurat e hapura dhe të kufizuara.</li> </ul> <p><i>Shërbimet A. 40(3)(a)</i></p>	<p>➔</p> <p><b>N. 32(2)(a)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>Shpjegimi i konceptit kur një ofertë ose kërkesë për pjesëmarrje nuk është e përshtatshme</i></li> </ul> <p><i>Shërbimet N. 50(a)</i></p>
<p><b>N. 31(1)(b) arsyet teknike ose artistike, ose arsyet e lidhura me mbrojtjen e të drejtave ekskluzive</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontratat e punëve, furnizimeve dhe shërbimeve</li> </ul> <p><i>Shërbimet N. 40(3)(c)</i></p>	<p>➔</p> <p><b>N. 32(2)(b) – i ristrukturuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>Arsyeja "artistike" e zgjeruar</i></li> <li><i>Baza të reja ku "konkurrenca mungon për arsye teknike"</i></li> <li><i>Kushtet e reja: ku konkurrenca mungon ose nuk ka nevojë për të, arsyet zbatohen vetëm nëse nuk ka alternativë të arsyeshme apo zëvendësim dhe jo ngushtim artificial të prokurimit</i></li> </ul> <p><i>Shërbimet A. 50(c)</i></p>
<p><b>N. 31(1)(c) Urgjencë ekstreme për shkak të ngjarjeve të paparashikuara</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontratat e punëve, furnizimeve dhe shërbimeve</li> </ul> <p><i>Shërbimet N. 40(3)(d)</i></p>	<p>➔</p> <p><b>N. 32(2)(c)</b></p> <p><i>Shërbimet N. 50(d)</i></p>
<p><b>N. 31(2)(a) Puna kërkimore, eksperimenti, studimi ose zhvillimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontratat e furnizimeve</li> </ul> <p><i>Shërbimet N. 40(3)(b)</i></p>	<p>➔</p> <p><b>N. 32(3)(a)</b></p> <p><i>Shërbimet N. 50(b)</i></p>
<p><b>N. 31(2)(b) Furnizimet shtesë si zëvendësim i pjesshëm apo zgjerim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontratat e furnizimeve</li> </ul> <p><i>Shërbimet N. 40(3)(e)</i></p>	<p>➔</p> <p><b>N. 32(3)(b)</b></p> <p><i>Shërbimet N. 50(e)</i></p>

<b>N. 31(2)(c) Tregu i mallrave</b> • Kontratat e furnizimeve <i>Shërbimet N. 40(3)(h)</i>	➔	<b>N. 32(3)(c)</b> <i>Shërbimet N. 50(g)</i>
<b>N. 31(2)(d) Kushtet favorizuese</b> • Kontratat e furnizimeve <i>Shërbimet N. 40(3)(k)</i>	➔	<b>N. 32(3)(d)</b> <i>Shërbimet N. 50(i)</i>
<b>N. 31(3) Konkursi i projektimit</b> • Kontratat e shërbimeve <i>Shërbimet N. 40(3)(l)</i>	➔	<b>N. 32(4)</b> <i>Shërbimet N. 50(j)</i>
<b>N. 31(4)(a) Kërkesat shtesë, të paparashikuara</b> kur ka shqetësim teknike • Kontrata punësh dhe shërbimesh <i>Shërbimet N. 40(3)(f)</i>	➔	• Ndryshuar dhe kaluar tek <b>N. 72(1)(b)</b> modifikimi i kontratave gjatë afatit dhe të ndryshuara <i>Shih komentin më poshtë për Nenin 72. Kaluar tek N. 89(1)(b)</i>
<b>N. 31(4)(b) Përsëritja e kërkesave të ngjashme</b> • Kontrata punësh dhe shërbimesh <i>Shërbimet N. 40(3)(g)</i>	➔	<b>N. 32(5)</b> <i>ndryshuar për të sqaruar kërkesën për projektin bazë për të përfshirë tregues të kërkesave të mundshme shtesë</i> <i>Shërbimet N. 50(f)</i>
<i>Shërbimet N. 40(3)(j) blerjet e volitshme</i> <b>Shënim:</b> <i>Këto arsye nuk kanë qenë të disponueshme në Direktivën e Sektorit Publik 2004.</i>	➔	<i>Shërbimet N. 50(h)</i> <b>Shënim:</b> <i>Këto arsye nuk janë të disponueshme në Direktivën e Sektorit Publik 2014.</i>

### Neni 33. Marrëveshjet kuadër

Dispozitat për marrëveshjet kuadër janë forcuar për të kërkuar rritjen e transparencës, veçanërisht në lidhje me (i) identifikimin e autoriteteve kontraktore që janë palë në marrëveshjen kuadër; dhe (ii) bazën mbi të cilën janë marrë vendimet në lidhje me mënyrën në të cilën kontratat janë dhënë bazuar në marrëveshjet kuadër.

#### Shërbimet:

Neni 51 përfshin edhe kërkesat e transparencës dhe parashikon që marrëveshjet kuadër nuk duhet të kalojnë në përgjithësi tetë vjet. Sipas Direktivës së Shërbimeve 2004, nuk ka pasur periudhë maksimale kohore të specifikuar.

### Neni 37. Aktivitetet e blerjes së përqendruar dhe organet qendrore të blerjes

Direktiva e Sektorit Publik 2014 përmban dispozita më të gjera për blerjen qendrore se sa Direktiva e Sektorit Publik 2004. Direktiva e Sektorit Publik e vitit 2014 përcakton dy kushte të reja: "aktivitetet qendrore të blerjes" dhe "aktivitetet ndihmëse të blerjes". Përkufizimi i aktiviteteve qendrore të blerjes në Direktivën e Sektorit Publik 2014 bazohen në përkufizimin e organit qendror të blerjes të parashikuar në Direktivën Sektorit Publik 2004. Përkufizimi i aktiviteteve ndihmëse të blerjes është tërësisht i ri.

Shtetet Anëtare kanë mundësi t'i lejojnë autoritetet kontraktore që të blejnë sa më poshtë vijon:

- Furnizime dhe/ose shërbime nga një organi qendror blerës duke bërë u mundësuar organeve qendrore blerëse që të kryejnë një lloj aktiviteti të magazinimit duke u bërë shitje drejtpërdrejt autoritetet kontraktore;

- Punët, furnizimet dhe shërbimet me anë të përdorimit kontratat, sistemet dinamike të blerjes ose marrëveshjet kuadër të dhëna ose të vendosura nga një organ qendror blerës.

**Dispozitat jo të detyrueshme:** Shtetet Anëtare gjithashtu kanë mundësinë që të kërkojnë që lloje të caktuara të prokurimit të kryhen duke përdorur një organ apo organe qendrore blerëse.

Neni 37 (2) i Direktivës së Sektorit Publik 2014 konfirmon se autoriteti kontraktor i përmbush detyrimet e tij kur ai:

- Blen furnizime apo shërbime nga një organi qendror blerës;
- Përdor sistemet dinamike të blerjes dhe marrëveshjet kuadër të krijuara nga një organ qendror blerës.

Megjithatë, sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014 autoriteti kontraktor është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të veta në lidhje me pjesët e këtyre procedurave të cilat i udhëheq vetë. Autoriteti kontraktor është përgjegjës, kur ai:

- Jep një kontratë bazuar në një sistem dinamik blerjeje;
- Ri-hap konkurrencën sipas një marrëveshje kuadër;
- Përcakton se cilit operator ekonomik duhet t'i jepet kontrata bazuar në një marrëveshjeje kuadër, kur konkurrenca nuk është rihapur.

Theksi është vendosur në rëndësinë e prokurimit elektronik. Një kërkesë e re përcakton që të gjitha prokurimet që kryhen nga organet qendrore blerëse duhet të realizohen duke përdorur mjete elektronike [Neni 37 (3)].

Dispozitat e reja kanë të bëjnë me "aktivitete ndihmëse të blerjes". Aktivitetet ndihmëse të blerjes janë aktivitete që mbështesin aktivitetet e blerjes, të tilla si sigurimi i infrastrukturës teknike, këshilla për organizimin apo planifikimin e aktiviteteve të prokurimit publik, si dhe përgatitjen dhe menaxhimin e proceseve të prokurimit. Autoritetet kontraktore mund t'ia japin kontratat për kryerjen e këtyre aktiviteteve një organi qendror blerës pa pasur nevojë të zbatojnë procedurat e parashikuara në Direktivën e Sektorit Publik 2014.

#### **Shërbimet:**

[Neni 55 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.](#)

#### **Neni 38. Prokurimi rastësor i përbashkët**

Neni 38 lejon që dy ose më shumë autoritete kontraktore të bien dakord për të kryer lloje të caktuara të veçanta të prokurimit të përbashkët. Ato mund ta bëjnë këtë ose duke ndarë përgjegjësinë e përbashkët ndërmjet autoriteteve kontraktore që marrin pjesë ose duke ndarë përgjegjësinë individuale tek autoritetet e ndryshme kontraktore.

#### **Shërbimet:**

[Neni 56 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.](#)

#### **Neni 40. Konsultimet paraprake të tregut**

Neni 40 i Direktivës së Sektorit Publik 2014 paraqet dispozita të reja që lejojnë në mënyrë specifike përdorimin e konsultimeve paraprake të tregut. Autoritetet kontraktore mund të zhvillojnë konsultime paraprake të tregut "me qëllim përgatitjen e prokurimit dhe informimin e operatorëve ekonomikë për planet e tyre të prokurimit". Kjo dispozitë e re zgjeron dukshëm në dialogun teknik të përmendur në hyrjen 8 të Direktivës Sektorit Publik 2004. Neni 40 përfshin një shembull kërkim të, ose pranimin e, këshilla nga ekspertë të pavarur, autoritetet apo pjesëmarrësit e tregut. Ky proces nuk duhet të shtrembërojë konkurrencën apo të shkelë parimet e mosdiskriminimit dhe të transparencës.

**Shërbimet:**

Neni 58 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

**Neni 41. Përfshirja paraprake e kandidatëve ose e ofertuesve**

Neni 41 paraqet dispozita të reja që pasqyrojnë praktikën gjyqësore të GJED.<sup>10</sup> Autoritetet kontraktore duhet të marrin masat e duhura për të siguruar që konkurrenca nuk shtrembërohet me pjesëmarrjen e një kandidati ose ofertuesi që ka pasur një përfshirje paraprake në këshillimin e autoritetit kontraktor ose në përgatitjes e procedurës. Neni 41 përfshin shembuj të llojeve të masave që autoriteti kontraktor mund të marrë në këtë drejtim.

Autoritetet kontraktore mund të përjashtojnë vetëm kandidatët ose ofertuesit për shkak të përfshirjes paraprake kur nuk ka mjete të tjera për të siguruar trajtim të barabartë. Nëse autoriteti kontraktor do të vendosë të përjashtojë mbi këtë bazë, atëherë ai duhet t'i japë kandidatit ose ofertuesit në fjalë mundësinë për të provuar se kjo përfshirje paraprake nuk do të shtrembërojë konkurrencën.

**Shërbimet:**

Neni 59 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

**Neni 42. Specifikimet teknike**

Ndryshimet kryesore të dispozitave që lidhen me specifikimet teknike reflektojnë theksin në rritje mbi vlerësimet sociale dhe mjedisore dhe mbi zhvillimin e jurisprudencës së GJED-së për këtë çështje.<sup>11</sup>

Neni 42 fillon duke konfirmuar se specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat e kërkuara të punëve, shërbimeve ose furnizimeve. Më tej ai parashikon se këto karakteristika mund t'i referohen:

- Procesit specifik apo metodës së prodhimit ose ofrimit të punës, furnizimit ose shërbimit;
- Një procesi specifik për një tjetër fazë të ciklit të jetës së punës, furnizimit ose shërbimit.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur faktorët e tillë nuk do të formojnë një pjesë të substancës materiale të punëve, furnizimeve ose shërbimeve, me kusht që faktorët të jenë proporcional dhe të jenë të lidhur me objektin e kontratës.

Kjo dispozitë mund të lejojë, për shembull, specifikimin e mjeteve miqësore me mjedisin e prodhimit ose të asgjësimit të një produkti apo të kërkesës që procesi i prodhimit të jetë në përputhje me parimet e tregtisë së drejtë. Pasi të zbatohet parimi i ekuivalencës, autoritetet kontraktore duhet të pranojnë produkte që plotësojnë kërkesat me çdo mjet të përshtatshëm.

Kur objekti i prokurimit është menduar për përdorim nga personat, atëherë specifikimet teknike duhet të marrin parasysh kriteret e aksesueshmërisë. Ky parim zbatohet ndaj përdorimit si nga publiku i gjerë ashtu edhe nga stafi i autoritetit kontraktor. Ky parim nuk zbatohet vetëm në rrethana të justifikuara sipas rregullave.

Specifikimet teknike mund t'i referohen edhe etiketave specifike. Shih koment mbi nenin 43 më poshtë.

**Shërbimet:**

Neni 60 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

<sup>10</sup> Në veçanti, aktgjykimi i GJED-së në Çështjen e bashkuar C-21/03 dhe C-34/03 FABRICOM.

<sup>11</sup> Në veçanti, vendimi i GJED-së për Çështjen C-368/10 Komisioni kundër Holandës në lidhje me përdorimin e tregtisë së drejtë dhe kërkesat mjedisore dhe etiketat



### Neni 43. Etiketat

Ndryshimet në lidhje me specifikimet teknike janë përfshirë në dispozitat e reja mbi përdorimin e etiketave të diskutuara më lart në nenin 42. Një autoritet kontraktor mund të kërkojë një etiketë të veçantë, ose një pjesë të një etikete, si provë se punët, furnizimet apo shërbimet korrespondojnë karakteristikat me të veçanta të mjedisit, sociale apo me karakteristikat e tjera. Kërkesa për një etiketë të saktë mund të përfshihet në specifikimet teknike, sipas kriterëve për dhënien e kontratës ose të kushteve të realizimit të kontratës.

Kur autoriteti kontraktor specifikon një etiketë të caktuar, ai mund të veprojë kështu vetëm kur përmbushet një numër kushtesh. Këto kushte janë të përcaktuara në Neni 43 (1) (a) deri në (e).

Zbatohet parimi i ekuivalencës, dhe, për këtë arsye, autoritetet kontraktore duhet të pranojnë etiketat ekuivalente dhe mjete të tjera të përshtatshme të provës.

#### Shërbimet:

Neni 61 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

### Neni 46. Lotet

Dispozitat për lotet janë zgjeruar me qëllim të inkurajimit të autoriteteve kontraktore për të ndarë kontratat në lote dhe për të rritur në këtë mënyrë pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Presumohet se kontrata do të ndahet në lote, ndërkohë që një **dispozitë jo e detyrueshme** i lejon Shtetet Anëtare që ta bëjnë përdorimin e loteve të detyrueshëm. Në dokumentet e prokurimit ose në kontratë autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë raportimin e arsyeve kryesore për çdo vendim për të mos të ndarë një kontratë në lote. Dispozitat tjera i lejojnë autoritetet kontraktore që të kufizojnë numrin e loteve për të cilat një ofertues mund të konkurrojë dhe të kombinojë dhënien e më shumë se një loti. Një tjetër **dispozitë jo e detyrueshme** e lejon autoritetin kontraktor që të kufizojë numrin e loteve që një ofertues mund të fitojë.

#### Shërbimet:

Neni 65 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme. Dallimi kryesor është se nuk ka asnjë kërkesë për të përcaktuar, as në dokumentet e prokurimit ose në raportin e kontratës, arsyet kryesore për një vendim për të mos të ndarë një kontratë në lote.

### Neni 48. Njoftimet Paraprake të Informacionit

**Dispozitat jo të detyrueshme – Njoftimi Paraprak i Informacionit si një thirrje për konkurrim:** Neni 48 i Direktivës së Sektorit Publik 2014 përmban një dispozitë jo të detyrueshme që paraqet një formë të re të Njoftimit Paraprak të Informacionit: "Njoftimi Paraprak i Informacionit si thirrje për konkurrim".

Njoftimi Paraprak i Informacionit si ftesë për konkurrim mund të përdoret nga:

- Autoritetet kontraktore "nën-qendrore" për kontratat plotësisht të rregulluara, domethënë kontrata që janë objekt i Direktivës së Sektorit Publik 2014 dhe nuk janë kontrata "të regjimit të lehtë";
- Të gjitha autoritetet kontraktore për kontratat e "regjimit të lehtë". Shih komentin më poshtë për nenet 74 në 76 për shpjegimin e "regjimit të lehtë".

Autoritetet nën-qendrore kontraktore janë autoritete që nuk janë organet kontraktore të qeverisjes qendrore të renditura në Aneksin 1.

Autoriteti kontraktor mund të përdorë Njoftimin Paraprak të Informacionit si thirrje për konkurrim për të shpallur një numër kontratash që do të prokurorë gjatë një periudhë deri në 12 muaj (dhe më gjatë në rastin e kontratave të regjimit të lehtë). Operatorët ekonomikë të interesuar për të konkurruar për kontratat e përshkruara në Njoftimin Paraprak të

Informacionit si ftesë për konkurrim duhet të shprehin interes duke iu përgjigjur këtij Njoftimi Paraprak të Informacionit. Nuk ka asnjë kërkesë për të publikuar ndonjë njoftim kontrate para fillimit të procesit të tenderimit. Autoriteti kontraktor fton ata operatorëve ekonomikë që kanë shprehur interes duke iu përgjigjur Njoftimit Paraprak të Informacionit si ftesë për konkurrim për të konfirmuar nëse ata janë të interesuar apo për të marrë pjesë në procesin e prokurimit.

Dispozitat e reja mbi Njoftimin Paraprak të Informacionit, si ftesë për konkurrim, janë të ngjashme me dispozitat e përfshira në Direktivën e Shërbimeve 2004 që i lejonte subjektet kontraktore që të shpallnin, të paktën një herë në vit, përdorimin e **njoftimeve treguese periodike** si një mjet për të bërë thirrje për konkurrim.

**Shërbimet:**

Neni 67 i Direktivës së Shërbimeve 2014 lejon përdorimin e njoftimeve periodike treguese, sipas dispozitave që janë të ngjashme me ato të nenit 48 të Direktivës së Sektorit Publik 2014. Shih komentin më lart mbi njoftimet treguese periodike (Neni 27).

**Neni 50. Njoftimet e Dhënies së Kontratës**

Në përputhje me synimin e përsheptimit të procesit të prokurimit, afati për paraqitjen e Njoftimeve të Dhënies së Kontratës është reduktuar në 30 ditë pas lidhjes së një kontrate ose marrëveshjeje kuadër. Sipas Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004 afati ishte 48 ditë.

Nuk ka asnjë detyrim për të publikuar Njoftimet e Dhënies së Kontratës për kontratat e dhëna në marrëveshjet kuadër. **Dispozitë jo e detyrueshme:** Shtetet Anëtare mund t'i kërkojnë autoriteteve kontraktore të publikojnë, në baza tremujore, Njoftimet e Dhënies së Kontratës në lidhje me dhënien e kontratave sipas marrëveshjeve kuadër.

**Shërbimet:**

Neni 70 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme. E njëjta dispozitë jo e detyrueshme është e disponueshme.

**Neni 53. Dokumentet e prokurimit që janë të disponueshme në mënyrë elektronike**

Sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014, një kërkesë e re i detyron autoritetet kontraktore që të ofrojnë akses të plotë dhe të pakufizuar, pa pagesë, në dokumentet përkatëse të prokurimit nga data e publikimit të Njoftimit të Kontratës (ose kur përdoret një Njoftim Paraprak i Kontratës si ftesë për konkurrim, që nga data kur është dërguar ftesa për të konfirmuar interesin).

Dokumentet e prokurimit janë përkufizuar në nenin 2 (13), si "çdo dokument që hartohet nga autoriteti kontraktor ose çdo dokument të cilit i referohet autoriteti kontraktor për të përshkruar apo për të përcaktuar elementet e prokurimit apo të procedurës, duke përfshirë Njoftimin e Kontratës, Njoftimin Paraprak të Informacionit, ku ai përdoret si mjet për të bërë thirrje për konkurrim, specifikimet teknike, dokumentin përshkrues të propozuar kushtet e kontratës, formatet për paraqitjen e dokumenteve nga kandidatët dhe ofertuesit, informacionin mbi detyrimet në përgjithësi në fuqi dhe çdo dokument tjetër shtesë".

**Koment:** Kjo kërkesë duket se mbulon dokumentet që përfshihen zakonisht në ftesën për ofertë. Kjo do të thotë se në procedurat me dy faza, të tilla si procedura e kufizuar, autoriteti kontraktor duhet ta vërë përmbajtjen e ftesës për ofertë në dispozicion që nga data e publikimit të njoftimit të kontratës ose që nga data e thirrjes për konkurrim dhe jon në një datë të mëvonshme, domethënë pas përfundimit të fazës së përzgjedhjes, siç parashikohet në Direktivën Sektorit Publik 2004.

Nuk ka kuptim për t'i vënë në dispozicion të gjitha dokumentet e tenderit në këtë datë të hershme për procedurat që përfshijnë një numër fazash, konkretisht dialogu konkurrues, procedura konkurruese me negociim, dhe partneritetet e inovacionit. Për këto procedura, detyrimi ndoshta vlen për fazën e përzgjedhjes dhe ftesën fillestare për ofertë ose pjesëmarrje në procedurë dhe jo për fazat e mëvonshme të procesit të negociatave.

## Shërbimet:

Neni 73 (1) i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

### Neni 57. Shkaqet e përjashtimit

Si shkaqeve të përjashtimit ashtu edhe qasjes që autoritetet kontraktore duhet të adoptojë kur përjashtojnë kandidatë ose ofertues i janë bërë ndryshime të rëndësishme.

Është e rëndësishme të theksohet se dispozitat e zbutjes apo të "vetë-pastrimit" tani i detyrojnë autoritetet kontraktore të marrin në konsideratë, mbi bazë të qasjes rast pas rasti, të dhënat nga ofertuesit që mund të justifikojnë një vendim për të mos i përjashtuar ata, pavarësisht nga ekzistenca e shkaqeve të përjashtimit. Këto dispozita janë në përputhje me praktikën gjyqësore të GJED-së, e cila kërkon që shkaqet e caktuara të përjashtimit të vlerësohen rast pas rasti ndërkohë që hedh dyshime mbi ligjshmërinë e përdorimit të listave të përjashtimit automatik. Për informacione të mëtejshme dhe komente mbi këtë temë shih Udhëzimin nr. 24 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Përdorimi i listave të përjashtimit automatik në prokurimin publik*.

Ashtu siç ishte rasti edhe sipas Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004, shkaqet e përjashtimit janë të ndara në shkaqe të detyrueshme dhe shkaqe jo të detyrueshme. **Dispozitë jo e detyrueshme:** Shtetet Anëtare mund të vendosin që t'i kthejnë një ose më shumë prej shkaqeve jo të detyrueshme në shkaqe të detyrueshme.

**Shkaqet e detyrueshme të përjashtimit:** Shkaqet e detyrueshme të përjashtimit të renditura në nenin 57 (1) të Direktivës së Sektorit Publik 2014 janë vepra të rënda për të cilat operatorët ekonomikë kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë. Veprat e listuara në Direktivën e Sektorit Publik 2004 në lidhje me pjesëmarrjen në organizata kriminale, korrupsion, mashtrim dhe pastrim parash janë përfshirë në Direktivën e Sektorit Publik 2014. Janë përfshirë edhe vepra të tjera të lidhura me terrorizmin, financimin e terrorizmit, punën e fëmijëve dhe format e tjera të trafikimit të qenieve njerëzore. Veprat e listuara si shkak i detyrueshëm i përjashtimit në nenin 57 (1) janë përcaktuar nga referencat e përditësuara të legjislacionit specifik të BE-së.

Neni 57 (1) sqaron se detyrimi për të përjashtuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me vendim të formës së prerë (i) është anëtar i organit administrativ, menaxhues ose mbikëqyrës të operatorit ekonomik, ose (ii) ka kompetencat e përfaqësimit, të vendimmarrjes ose të kontrollit.

**Dispozitë jo e detyrueshme:** Shtetet Anëtare mund të parashikojnë shmangie nga shkaqe të detyrueshme të përjashtimit në kushte të jashtëzakonshme "për arsye thelbësore që kanë të bëjnë me interesin publik, si shëndeti publik ose mbrojtja e mjedisit".

**Shkaqet jo të detyrueshme të përjashtimit:** Disa nga shkaqet jo të detyrueshme të përjashtimit sipas Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004 janë ndryshuar dhe zgjeruar në Direktivën 2014 Sektorit Publik, e cila përfshin edhe shkaqe shtesë për përjashtimin që nuk ishin të përfshira në Direktivën Sektorit Publik 2004. Këto shkaqe shtesë janë, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

- Mospërputhje me të drejtën mjedisore, sociale dhe të punës sipas nenit 18 (2);
- Shenja të mundshme të një marrëveshje ndërmjet operatorëve ekonomik që kanë për qëllim shtrembërimin e konkurrencës;
- Konflikti i interesit që lind gjatë kryerjes së procesit të prokurimit, i cili nuk mund të rregullohet me masa që janë më të buta se përjashtimi;
- Shtrembërimi i konkurrencës për shkak të përfshirjes paraprake të operatorëve ekonomikë në përgatitjen e procedurës së prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet me masa që janë më të buta se përjashtimi;
- Mangësi të mëdha apo të vazhdueshme në realizimin nga ana e operatorit ekonomik të një kërkesë thelbësore bazuar në një kontratë të mëparshme publike apo kontratë

të koncesionit, të cilat kanë çuat në ndërprerjen e hershme të kontratës paraprake, në dëme ose sanksione të tjera të ngjashme;

- Ku operatori ekonomik është përpjekur që të ndikojë padrejtësisht në procesin e vendim-marrjes, që të marrë informacion konfidencial, ose që të japë informacion mashtrues.

**Zbutja ose "vet-pastrimit":** Direktiva e Sektorit Publik 2014 përfshin një parim të ri që është ai zbutjes ose i "vetë-pastrimit", nga i cili duhet të përfitojnë operatorët ekonomikë të cilët ballafaqohet me mundësinë e përjashtimit nga procesi i tenderit.

Neni 57 (6) parashikon se operatori ekonomik ka të drejtë të sigurojë prova që tregojnë besueshmërinë e tij, pavarësisht nga ekzistenca e shkaqeve të detyrueshme ose jo të detyrueshme të përjashtimit. Nëse një provë e tillë çmohet nga autoriteti kontraktor si e mjaftueshme, atëherë operatori ekonomik nuk do të përjashtohet. Neni 57 (6) liston llojet e dëshmimeve që mund të jenë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e kërkuar. Autoritetet kontraktore janë të detyruara të marrin parasysh seriozitetin dhe rrethanat e veçanta të veprës penale ose të shkeljes. Nëse autoriteti kontraktor vendos që provat janë të pamjaftueshme, atëherë ai duhet t'i paraqesë operatorit ekonomik një deklaratë që tregon arsyet për vendimin e tij.

**Koment:** Nuk është plotësisht e qartë nga formulimi i Neni 57 (6) nëse lista e provave që operatori ekonomik duhet të ofrojë është një listë e plotë apo jo, ose nëse mund të ketë një listë ilustruese të llojeve të provave që mund të jenë të përshtatshme. Në praktikë, ka më shumë kuptim që kjo listë të jetë një listë ilustruese, pasi provat e përcaktuara në nenin 57 (6) nuk janë të rëndësishme për të gjitha shkaqet e përjashtimit.

### Shkelja e detyrimeve të lidhura me pagimin e taksave apo të detyrimeve të sigurimeve shoqërore.

**Shkaku jo i detyrueshëm:** Sipas Direktivës Sektorit Publik të vitit 2004, përjashtimi i një operatori ekonomik në bazë të një shkelje të detyrimeve të tij lidhur me pagimin e tatimeve apo detyrimeve të sigurimeve shoqërore ishte një shkak jo i detyrueshëm. Sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014, ky përjashtim vazhdon të përbëjë një bazë jo të detyrueshme kur një autoritet kontraktor mund të tregojë një shkelje të këtyre detyrimeve "me çdo mjet të përshtatshëm".

Megjithatë, Direktiva e Sektorit Publik 2014 parashikon që ky shkak jo i detyrueshëm i përjashtimit nuk zbatohet më kur operatori ekonomik ka përmbushur detyrimet e tij ose duke paguar, ose duke hyrë në një marrëveshje të detyrueshme për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore që duhen paguar.

**Shkaku i detyrueshëm:** Sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014, shkelje e detyrimeve lidhur me pagimin e tatimeve ose kontributeve të sigurimeve shoqërore përbën tashmë një shkak të detyrueshëm të përjashtimit kur "shkelja është përcaktuar me vendim gjyqësor apo administrativ që është i formës së prerë dhe efekt detyrues bazuar në vendin në të cilin është marrë vendimi, ose në Shtetin Anëtar të autoritetit kontraktor". **Dispozita jo e detyrueshme:** Shtetet Anëtare mund të zgjedhin të përdorin dy përjashtime nga shkaqet e detyrueshme të përjashtimit:

- Në baza përjashtimore, "për arsye thelbësore në lidhje me interesin publik të tilla si shëndeti publik ose mbrojtja e mjedisit";
- Kur përjashtimi do të ishte disproporcional; Direktiva e Sektorit Publik 2014 jep shembuj të rrethanave të tilla.

**Periudhat maksimale të përjashtimit:** Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë periudhat maksimale të përjashtimit që t'i përfshijnë në masat e tyre kombëtare në zbatim të Direktivës së Sektorit Publik 2014, në varësi të periudhave të caktuara maksimale.

### Shërbimet:

Neni 80 i Direktivës së Shërbimeve 2014 lejon, por nuk i detyron, Shtetet Anëtare që të zbatojnë ndaj subjektet kontraktore në përgjithësi shkaqet e detyrueshme dhe jo të detyrueshme të përjashtimit të përcaktuara në Neni 57 të Direktivës së Sektorit Publik 2014. Megjithatë, shtetet anëtare janë të detyruara të zbatojnë nenet 57 (1) dhe 57 (2) të Direktivës së Sektorit Publik 2014 për subjektet kontraktore që janë autoritete kontraktore. Në secilin rast, shkaqet duhet të zbatohen në përputhje me kushtet përkatëse dhe kushtet e përcaktuara në Neni 57 të Direktivës së Sektorit Publik 2014.

### Neni 67. Kriteret e dhënies së kontratës

Direktiva e Sektorit Publik e vitit 2004 parashikonte që kontratat të jepeshin duke përdorur një nga dy kriteret, ose (i) ofertën ekonomikisht më të favorshme ose (ii) të ofertën me çmimin më të ulët.


Direktiva e Sektorit Publik e vitit 2014 ndryshon qasjen dhe vë theks më i madh në vlerësimin e kritereve të tjera përveç vetëm çmimit.

Neni 67 (2) shprehet të se "autoritetet kontraktore e bazojë dhënien e kontratave publike në ofertën ekonomikisht më të favorshme". Koncepti i ofertës ekonomikisht më të favorshme shpjegohet më tej si vijon:

"Oferta ekonomikisht më e favorshme nga pikëpamja e autoritetit kontraktor identifikohet në bazë të çmimit ose koston, duke përdorur qasjen e kosto-efektivitetit, të tillë si kostoja e ciklit të jetës ... dhe mund të përfshijë raportin më të mirë çmim-cilësi, i cili do të vlerësohet në bazë të kritereve, duke përfshirë aspektet cilësore, mjedisore dhe/ose sociale të lidhura me objektin e kontratës publike në fjalë .... " më pas neni vazhdon të japë shembuj të kritereve që mund të përdoren për të vlerësuar "raportin më të mirë çmim-cilësi".

Koment: Formulimi i Neni 67 (2) nuk është i qartë dhe është i hapur për interpretime të ndryshme. Kjo mungesë e qartësisë është rezultat i një kompromisi të papërsosur të arritur në mes të Parlamentit Evropian, i cili donte të eliminonte përdorimin e kriterit të çmimit më të ulët, dhe Komisionit Evropian, i cili dëshironte të mbante kriterin e çmimin më të ulët ose të fuste koston më të ulët si kriter. Recitali 89 i Direktivës së Sektorit Publik 2014 nuk jep ndonjë ndihmë duke shpjeguar se termi "oferta ekonomikisht më e favorshme" që është përdorur në Direktivën e Sektorit Publik të vitit 2004 tani njihet si "raporti më i mirë çmim-cilësi" sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014.

Interpretimi i dispozitave është ilustruar më poshtë.



Është e mundur që të përdoret vetëm çmimi ose kostoja si kriter i vetëm për dhënien e kontratës nëse një Shtet Anëtar zgjedh të adoptojë paragrafin e fundit të Neni 67 (2). Sipas kësaj **dispozite jo të detyrueshme**, Shtetet Anëtare kanë mundësinë të përcaktojnë që autoritetet kontraktore nuk mund të përdorin vetëm çmimin ose koston si kriter i vetëm për dhënien e kontratës.

**Koment:** Është e hapur për debat nëse ka ndodhur shumë ndryshim në praktikë apo jo. Autoritetet kontraktore ende mund të japin kontrata në bazë vetëm të çmimit ose vetëm të koston. Ato gjithashtu mund të përdorin qasjes e "raportit çmim-cilësi", që është ekuivalente e "ofertës ekonomikisht më të favorshme" sipas Direktivës së Sektorit Publik 2004. Ndoshta ndryshimet e mëdha janë kërkesat për të përdorur "qasjen e kosto-efikasitetit" në vlerësimin e koston dhe të kërkesave të reja të nenit 68 në lidhje me koston e ciklit të jetës.

Dispozitat e mëtejshme të Direktivës së Sektorit Publik lidhen me ndryshimet që pasqyrojnë edhe praktikën gjyqësore të GJED-së dhe fokusin e Evropë 2020 në çështjet mjedisore në prokurim. Neni 67 (3) konfirmon se kriteret e dhënies së kontratës duhet të konsiderohen si të lidhura me objektin e kontratës kur ato kanë të bëjnë me çdo fazë të ciklit të jetës së punëve, furnizimeve ose shërbimeve që do të prokurohen. Ky cikël i jetës mund të përfshijë proceset specifike të prodhimit, ofrimit ose të tregtimit.


Një dispozitë e re gjithashtu lejon përdorimin e kriterëve të dhënies së kontratës që kanë të bëjnë me organizimin, kualifikimin dhe përvojën e personelit të caktuar për realizimin e kontratës. Këto kriterë mund të përdoret "kur cilësia e personelit të caktuar për realizimin e kontratës mund të ketë ndikim të rëndësishëm në nivelin e zbatimit të kontratës". Kjo dispozitë sqaron paqartësitë që rrjedhin nga një aktgjykim i GJED-së që disa komentues e kanë interpretuar sikur ajo nënkupton se ky lloj kriteri mund të përdoret vetëm si kriter i fazës së përzgjedhjes dhe nuk mund të përdoret si kriter për dhënien e kontratës.<sup>12</sup>

#### Shërbimet:

Neni 82 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

#### Neni 68. Kostoja e ciklit të jetës

Siç është përmendur më lart, Neni 67 (2) duket se ka kuptimin që kur një autoritet kontraktor vendos të japë një kontratë në bazë të koston, atëherë ai duhet të përdorë qasjen e kosto-efektivitetit. Cikli i koston së jetës është një shembull i qasjes së kosto-efektivitetit. Neni 68 përcakton konceptin e koston së ciklit të jetës nga këndvështrimi i BE-së si kosto që përballohen nga autoriteti kontraktor ose përdoruesit e tjerë, siç ilustron më poshtë:



Kur autoritetet kontraktore përdorin qasjen e koston së ciklit të jetës, ata duhet të përfshijnë në dokumentet e prokurimit informacion mbi të dhënat që duhet të jepen nga operatorët ekonomikë

<sup>12</sup> C-532/06 Lianakis.

dhe për metodën që autoriteti kontraktor do të përdorë për t'i vlerësuar këto të dhëna. Metoda e përdorur duhet të përmbushë një numër kushtesh të renditura në nenin 68 (2) (a) deri (c) në lidhje me transparencën dhe aksesueshmërinë.

Ku ka legjislacioni i BE-së imponon metodën për llogaritjen e kostos së ciklit të jetës, atëherë kjo metodë duhet të përdoret. Në Aneksin XIII të Direktivës së Sektorit Publik 2014 është e shënuar vetëm një metodë e detyrueshme në lidhje me specifikimet e automjeteve të pastra dhe të efektshme në energji të transportit rrugor<sup>13</sup> në bazë të Direktivës 2009/33/KE. Futja në nivel të BE-së e metodave shtesë të detyrueshme të kostos së ciklit të jetës është një mundësi.

#### **Shërbimet:**

[Neni 83 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.](#)

#### **Neni 69. Ofertat anomalisht të ulëta**

Ndryshimi kryesor në dispozitat në lidhje me ofertat anomalisht të ulëta ka të bëjë me çështjen nëse një autoritet kontraktor është i detyruar apo jo të hetojë një ofertë anomalisht të ulët. Sipas Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004, autoriteti kontraktor ishte subjekt i detyrimit për të hetuar një ofertë që dukej se ishte anomalisht e ulët, vetëm nëse ai kishte ndërmend ta hidhte poshtë këtë ofertë. Direktiva e Sektorit Publik e vitit 2014 kërkon që autoriteti kontraktor të hetojë të gjitha ofertat anomalisht të ulëta, pavarësisht nga qëllimet e tij për të pranuar ose refuzuar një ofertë të tillë.

#### **Shërbimet:**

[Neni 84 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.](#)

#### **Neni 71. Nënkontraktimi**

Dispozitat për nënkontraktimin sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014 janë shumë më të gjera. Neni 25 i Direktivës së Sektorit Publik 2004 lejonte ose kërkonte që autoritetet kontraktore të kërkonin që një ofertues të tregonte çdo pjesë të kontratës që ai synonte të nënkontraktonte dhe çdo nënkontraktor të propozuar. Ky parim është përfshirë në nenin 71 (2) të Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2014. Neni 71 vazhdon të përfshijnë dispozita të tjera lidhur me nënkontraktimin.

**Informacion në lidhje me nënkontraktorët:** Kontraktori kryesor duhet të japë të dhënat e nënkontraktorëve, dhe ndryshimet e nënkontraktorëve që punojnë në një objekt nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të autoritetit kontraktor. Kjo kërkesë zbatohet pas dhënies së kontratës dhe jo më vonë se kur fillon koha e realizimit të kontratës. Autoritetet kontraktore kanë diskrecion për t'i zgjeruar këto kërkesa, për shembull, për nënkontraktorët që ndodhen më poshtë në zinxhirin e nënkontraktimit.

**Përputhshmëria me detyrimet sipas të drejtës mjedisore, sociale dhe të punës,** në bazë të nenit 18 (2) dhe **shkaqet e tjera të përjashtimit:** Kjo përputhshmëri përfshin, sipas rastit, mekanizmat e përgjegjësive së përbashkët dhe verifikimin se shkaqet përkatëse të përjashtimit nuk zbatohet për nënkontraktorët. Kjo gjithashtu ka të bëjë me detyrimet e kontraktorit kryesor për të zëvendësuar një nënkontraktor që është subjekt i shkaqeve të tjera të përjashtimit.

**Dispozitat jo të detyrueshme: pagesa direkte për nënkontraktorët:** Shtetet anëtare mund të miratojnë masat që lejojnë pagesa direkte nga ana e autoritetit kontraktor për një nënkontraktor, me ose pa kërkesën e nënkontraktorit.

**Koment:** Është ende e paqartë nëse është e lejueshme apo jo sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014 që autoritetet kontraktore të kërkojnë apo jo nënkontraktimin e një minimumi të caktuar ose të një pjese maksimale të një kontrate.

<sup>13</sup>Automjetet e transportit rrugor në këtë kontekst janë veturat, autobusët, automjetet e lehta tregtare dhe automjetet e rënda të mallrave

## Shërbimet:

Neni 88 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

### Neni 72. Modifikimi i kontratave ose i marrëveshjeve kuadër gjatë kohëzgjatjes së tyre

Direktiva e Sektorit Publik e vitit 2004 ka pasur dispozita shumë të kufizuara në lidhje me modifikimin e kontratave ose marrëveshjeve kuadër gjatë kohëzgjatjes së tyre. Këto dispozita lidheshin me rastet kur lejohej përdorimi i procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Neni 72 i Direktivës së Sektorit Publik 2014 përmban dispozita shumë më të gjera. Disa nga këto dispozita janë të lidhura me jurisprudencën e GJED-së dhe janë zgjeruar mbi bazën e saj.<sup>14</sup>

Sipas Direktivës së Sektorit Publik 2014, ekzistojnë gjashtë rrethana në të cilat kontratat ose marrëveshjet kuadër mund të modifikohen gjatë kohëzgjatjes së tyre pa rezultuar në kërkesën për një procedurë të re konkurruese për dhënien e kontratës. Në mënyrë të përmbledhur, këto rrethana janë si më poshtë vijon:

- 1) Modifikimet që janë parashikuar në mënyrë të qartë në dokumentet fillestare të prokurimit [Neni 72 (1) (a)]:** Kur dokumentet fillestare të prokurimit parashikojnë që modifikimet të bëhen në "klauzola të qarta, të sakta dhe pa ekuivoke", atëherë këto modifikime lejohen. Shtrirja dhe natyra e modifikimeve të mundshme duhet të jenë të qarta, ashtu siç duhet të jenë kushtet në të cilat mund të përdoren klauzolat e shqyrtimit.
- 2) Modifikimet e nevojshme, kur nuk mund të bëhet ndryshimi i kontraktorit [Neni 72 (1) (b)]:** Kontraktori origjinal mund të dorëzojë kërkesa shtesë si një "modifikim të nevojshëm" kur ndryshimi i kontraktorit (i) nuk mund të bëhet për arsye ekonomike ose teknike dhe (ii) do të shkaktoje shqetësim të rëndësishëm ose një rritje të konsiderueshme të kostos për autoritetin kontraktor.  
  
Ky modifikim lejohet vetëm nëse rritja e kostos nuk kalon 50% të vlerës së kontratës fillestare. Është e mundur që të bëhen disa modifikime, dhe rritja 50% e kostos vlen për çdo modifikim të veçantë. Kur autoriteti kontraktor mbështetet në këtë dispozitë, atëherë ai duhet të publikojë një njoftim në *GZBE* duke përdorur një njoftim të veçantë me format standard.
- 3) Modifikimet që merren me rrethana të paparashikuara [Neni 72 (1) (c)]:** Kur paraqiten rrethana të cilat autoriteti kontraktor nuk mund t'i kishte parashikuar, atëherë është e mundur që kontrata të ndryshohet pa një procedurë të mëtejshme të prokurimit. Ky modifikim lejohet kur (i) kjo nuk e ndryshon natyrën e përgjithshme të kontratës, dhe (ii) rritja e kostos nuk kalon 50% të vlerës së kontratës fillestare. Është e mundur që të bëhen disa modifikime, ndërkohë që 50% e rritjes së limitit të kostos vlen për çdo modifikim të veçantë. Kur autoriteti kontraktor mbështetet në këtë dispozitë, atëherë ai duhet të publikojë një njoftim në *GZBE*, duke përdorur një njoftim të veçantë me format standard.
- 4) Modifikimet që merren me kontraktorin e ri që zëvendëson kontraktorin fillestar [Neni 72 (1) (d)]:** Një kontraktor i ri mund të zëvendësojë kontraktorin origjinal në tri raste. Këto raste janë kur:
  - Një klauzolë apo opion i qartë i shqyrtimit është në përputhje me Neni 72 (1) (a);
  - Ka ndodhur një "suksedim universal ose i pjesshëm në pozitën e kontraktorit fillestar pas ristrukturimit të korporatës, duke përfshirë marrjen nën kontroll të shoqërive me ofertë publike, bashkimin, blerjen apo paaftësinë paguese ..."; zëvendësimi mund të bëhet me kusht që (i) kontraktori i ri plotëson kriteret e para-kualifikimit të vendosura fillimisht, dhe (ii) ndryshimi i kontraktorit nuk rezulton në ndryshime të tjera në kontratë;

<sup>14</sup> Shih shënimin fundor 3



- Autoriteti kontraktor merr përsipër rolin e kontraktorit kryesor në mënyrë që të marrë përsipër detyrimet ndaj nënkontraktorëve të tij.

#### 5) Modifikimet që "nuk janë të rëndësishme" [Neni 72(1)(e) dhe 72(4)]

Modifikimet thelbësore janë ndryshime që e bëjnë kontratën "materialisht të ndryshme në karakter" nga kontrata fillestare. Modifikimet që "nuk janë thelbësore" mund të bëhen me një kontratë pa një kërkesë për të ndërmarrë një procedurë të re të prokurimit. Neni 72 (4) përfshin një listë jo shteruese të modifikimeve që gjithmonë do të konsiderohen si thelbësore dhe, për këtë arsye, do të kërkojnë një procedurë të re të prokurimit.

#### 6) Modifikimet me vlerë të ulët [Neni 72 (2)]

Nëse vlera që i atribuohet ndryshimit është e ulët, atëherë modifikimi lejohet. Një modifikim konsiderohet të jetë me vlerë të ulët, kur ai nuk e ndryshon natyrën e përgjithshme të kontratës dhe kur vlera e modifikimit klasifikohet nën kufirin monetar përkatës të prokurimit dhe është më pak se 10% të vlerës fillestare të kontratës për furnizime dhe shërbime kontratave ose më pak se 15% e vlerës fillestare të kontratës për një kontratë pune. Vlerat e modifikimeve llogariten në mënyrë kumulative. Vlera e përgjithshme e të gjitha modifikimeve me vlerë të ulët nuk duhet të kalojë kufirin monetar përkatës të prokurimit.

**Koment:** Çdo shkelje e këtyre dispozitave mund të jenë subjekt i procedurave ligjore. Çdo Shtet Anëtar përcakton forumin e përshtatshëm për veprime ligjore.

#### Shërbimet:

Neni 89 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

#### Neni 73. Përfundimi i kontratave

Direktiva e Sektorit Publik i vitit 2014 përmban dispozita të reja, të cilat nuk i përmbante Direktiva e Sektorit Publik të vitit 2004, duke mbuluar rrethanat ku autoritetet kontraktore duhet që të kenë mundësinë e ndërprerjes së kontratës. Këto rrethana janë si më poshtë:

- **Modifikimet thelbësore të kontratës:** kur kontrata ka qenë subjekt i një modifikimi thelbësor që do të kishte kërkuar një procedurë të re të prokurimit, në përputhje me Neni 72;
- **Shkaqet e detyrueshme të përjashtimit;** ku një prej shkaqeve të detyrueshme për përjashtim të listuara në Neni 57 (1) të aplikuar ndaj kontraktorit në kohën e dhënies së kontratës;
- **Shkelja e deklaruar nga GJED-ja:** kur kontrata "nuk duhej t'i ishte dhënë kontraktorit në funksion të një shkelje të rëndë të detyrimeve sipas Traktateve dhe [Direktivës së Sektorit Publik 2014] që është deklaruar nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimi Evropian në një procedurë në përputhje me Neni 258 të TFBE-së."<sup>15</sup>

**Koment:** Shtetet Anëtare janë të lira të vendosin se si t'i zbatojnë më mirë këto dispozita në mënyrë që të pasqyrojnë sistemet e tyre ligjore kombëtare. Është e mundur, për shembull, që një Shtet Anëtar të mund të përfshijë në legjislacionin e tij zbatues një kërkesë nga ana e autoriteteve kontraktore për të përfshirë një klauzolë të caktuar të kontratës në të gjitha kontratat. Shtetet e tjera Anëtare mund të vendosin një detyrim të përgjithshëm për autoritetet kontraktore në përputhje me Neni 73 duke i lënë detajet në diskrecionin e autoriteteve kontraktore.

#### Shërbimet:

Neni 90 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

<sup>15</sup> Procedura e nisur në bazë të nenit 258 të TFBE-së është një çshtje e paraqitur nga Komisioni Evropian kundër një shteti anëtar.

## Regjimet e Veçanta të Prokurimeve

### Nenet 74-76 "Regjimi i lehtë"

Sipas Direktivës së Sektorit Publik 2004, për dhënien e kontratave të shërbimit zbatoheshin dy lloje rregullash. Shërbimet e renditura në Aneksin II A të Direktivës së Sektorit Publik të vitit 2004 kanë qenë subjekt i zbatimit të plotë të kësaj Direktive. Të gjitha shërbimet e tjera, të renditura në Aneksin II B, kanë qenë subjekt vetëm i rregullimit të kufizuar.

Dallimi ndërmjet shërbimeve të Aneksit II A dhe Aneksit II B tani është hequr. Në vend të kësaj, Direktiva e Sektorit Publik e vitit 2014 paraqet një regjim të veçantë për dhënien e kontratave për shërbime të veçanta sociale dhe të tjera të listuara në Aneksin XIV të Direktivës.

Shërbimet që nuk janë të listuara në Aneksin XIV janë subjekt i zbatimit të plotë të Direktivës së Sektorit Publik 2014. Shërbimet e listuara në Aneksin XIV janë subjekt i një "regjimi të lehtë", ku vlera e kontratës tejkalon kufirin financiar prej 750 000 Euro. Lista e shërbimeve në Aneksin XIV është mjaft e ngjashme, por jo identike me listën e shërbimeve të Aneksit II B në Direktivën e Sektorit Publik 2004. Shërbimet e Aneksi XIV përfshijnë kryesisht shërbimet shëndetësore, sociale dhe kulturore.

Shtetet anëtare duhet të miratojnë rregullat kombëtare për dhënien e kontratave për shërbime "të regjimit të lehtë" që i nënshtrohen përputhjes me një numër të kufizuar të dispozitave të përcaktuara në nenet 75-76 të Direktivës së Sektorit Publik 2014. Dispozitat e Direktivës së Sektorit Publik 2014 kanë të bëjnë me sa më poshtë:

- **Shpallja:** Shërbimet e "regjimit të lehtë" duhet të shpallen në *GZBE*, ose duke përdorur formën standarde të njoftimit të kontratës ose Njoftimin Paraprak të Informacionit (NPI) si ftesë për konkurrim. Autoritetet kontraktore duhet të publikojë Njoftimin e Dhënies së Kontratës në *GZBE*.
- **Parimet e dhënies së kontratave:** Rregullat kombëtare duhet të jenë në përputhje me parimet e transparencës dhe të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik. Autoritetet kontraktore mund të marrin parasysh nevojën për të siguruar cilësi, vazhdimësi, akses, përbalueshmëri, dhe një numër faktorësh të tjerë të listuar.

**Dispozitat jo të detyrueshme:** Shtetet Anëtare mund të specifikojë gjithashtu se zgjedhja e ofruesit të shërbimeve duhet të bëhet në bazë të "raportit më të mirë çmim-cilësi".

#### Shërbimet:

Nenet 91-93 dhe Shtojca XVII e Direktivës së Shërbimeve 2014 përmbajnë dispozita shumë të ngjashme. Kufiri financiar është më i lartë, i vendosur në vlerën 1 000 000 Euro (1 milion Euro).

### Neni 77. Kontratat e rezervuara për disa shërbime "të regjimit të lehtë"

**Dispozita jo të detyrueshme:** Një dispozitë jo të detyrueshme është e lidhur me "regjimin e lehtë". Kjo dispozitë i lejon Shtetet Anëtare që të kufizojnë pjesëmarrjen në proceset e tenderimit për disa shërbime "të regjimit të lehtë" në një lloj të veçantë të organizimit. Lista e shërbimeve për të cilat zbatohet kjo dispozitë jo e detyrueshme është shumë më e ngushtë se lista e Aneksit XIV dhe fokusohet në shërbimet shëndetësore dhe sociale. Pjesëmarrja në procesin e tenderit mund të kufizohet në organizatat që plotësojnë kushtet në lidhje me objektivat e tyre, pronësinë, strukturën e menaxhimit dhe kontratat që kanë qenë dhënë më parë. Qëllimi i kësaj dispozite jo të detyrueshme është që të kufizojë pjesëmarrjen në procesin konkurrues për organizatat në pronësi të punonjësve dhe për organet e ngjashme.

#### Shërbimet:

Neni 91 i Direktivës së Shërbimeve 2014 përmban dispozita shumë të ngjashme.

## Informacion i mëtejshëm

### Burime të tjera

Faqja e internetit të Komisionit Evropian për prokurimin publik:

[https://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/rules-implementation\\_en](https://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/rules-implementation_en)